



Njësia Nr./Br./No 01 (Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 332 Nr. i faq./Br.str./No pg 01

Data/Datum/Date 31.05.2022

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 shkronja (d), nenit 14, nenit 17 paragrafi 1 shkronja (c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr-03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 30/2013”), Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) 01 Nr. 2566 i datës 30.05.2013, nenit 10 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.4, nenit 39, nenit 40, nenit 57 paragrafi 1 pika 1.3 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit me Nr. Prot. 1005 të datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 31.05.2022, merr këtë:

## V E N D I M

### Për caktimin e lokacionit për hapësirë për biznese

1. Me këtë vendim caktohet lokacioni për hapësirë për biznese në Komunën e Rahovecit.
2. Lokacioni i cekur në pikën 1 të këtij vendimi do të jetë në parcelat kadastrale, si në vijim:
  - 2.1. Parcela kadastrale sipas certifikatës së pronësisë Nr. P-71513005-01704-0, në zonën kadastrale Krushë e Madhe, në vendin e quajtur Rasa-Sprud, me sipërfaqe të përgjithshme prej 143712m<sup>2</sup> (njëqind e dyzet e tre mijë e shtatëqind e dymbëdhjetë metra katror), e evidentuar në posedim të Komuna e Rahovecit.
  - 2.2. Parcela kadastrale sipas certifikatës së pronësisë Nr. P-71513005-02745-0, në zonën kadastrale Krushë e Madhe, në vendin e quajtur Rasa-Sprud, me sipërfaqe të përgjithshme prej 381960m<sup>2</sup> (treqind e tetëdhjetë e një mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë metra katror), e evidentuar në posedim të Komuna e Rahovecit.
3. Parcelat e cekura në pikën 2 të këtij vendimi sipas Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) 01 Nr. 2566 të datës 30.05.2013 kanë destinim si Tokë Bujqësore Klasa e Bonitetit II.
4. Pronat e paluajtshme nuk e ndërrojnë titullarin juridik, pronar i saj mbetet Kuvendi Komunal i Rahovecit dhe si e tillë nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë.
5. Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit që të bëjë parcelizimin dhe skicimin në teren dhe regjistrimin e gjendjes në librat kadastral.
6. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.
7. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për

shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

**Vendimi u dërgohet:**

- MAPL-së,
- Arkivi.

## KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEÇ

**01-Nr.332/22**  
**Datë:31.05.2022**

